

**32000R2700**

**Rregullore (KE) nr. 2700/2000 e Parlamentit European dhe Këshillit e 16 Nëntorit 2000** mbi ndryshimin e Rregullores se Këshillit (KEE) nr. 2913/92 që përcakton Kodin Doganor të Komunitetit.

*Gazeta Zyrtare L311, 12/12/2000 fq.0017-0020*

Rregullore (KE) nr. 2700/2000 e Parlamentit European dhe Këshillit e 16 Nëntorit 2000 mbi ndryshimin e Rregullores se Këshillit (KEE) nr. 2913/92 që përcakton Kodin Doganor të Komunitetit.

## **PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN**

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European dhe në veçanti nenet 26, 95 dhe 133 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit <sup>(1)</sup>,

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social, <sup>(2)</sup>

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit, <sup>(3)</sup>

Duke pasur parasysh që:

- (1) Neni 253 pika (4) e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2913/92 i datës 12 Tetor 1992 që përcakton Kodin Doganor të Komunitetit <sup>(4)</sup>, parashikon që, përpara datës 1 janar 1998, Këshilli duhet në bazë të një raporti të Komisionit i cili mund të shoqërohet me propozime, të rishikojë Kodin në mënyrë që të bëjë përshtatjet e nevojshme, duke marrë parasysh në veçanti arritjen e tregut të brendshëm.
- (2) Çdo rishikim i Kodit që nuk krijon barrierë ndaj tregtisë ndërkombëtare duhet parë si një mundësi për të futur instrumente dhe procedura për parandalimin e mashtrimit, një nga mënyrat më të mira për kursimin e parave të taksapaguesve siç theksohet në përfundimet e Këshillit e 19 Majit 1998.
- (3) Duhet të merret parasysh rezoluta e Këshillit e 25 tetorit 1996 mbi thjeshtëzimin dhe arsyetimin e rregulloreve dhe procedurave doganore të Komunitetit <sup>(5)</sup>.
- (4) Kompetencat e autoriteteve të ndryshme për të përcaktuar kurset e këmbimit pas futjes së euros nuk janë vendosur akoma.

- (5) Dispozitat duhet të hartohen mbi mundësinë e depozitimit të deklaratave doganore me anën e teknologjisë së përpunimit të dhënave të pashoqëruara nga dokumentacioni përkatës.
- (6) Për ta bërë më të lehtë përfitimin e avantazheve nga masat për përpunim të brendshëm, përpunimit nën kontrollin e doganave dhe importin e përkohshëm, rregullat duhet të bëhen më elastike.
- (7) Është e arsyeshme të hartohen dispozita, në përputhje me procedurat e komitetit, për rastet shtesë në të cilat tarifatat nga masat për përpunim të jashtëm janë llogaritur duke marrë si bazë koston e veprimeve të përpunimit.
- (8) Në disa zona të lira mund të jetë i përshtatshëm lejimi i përmbushjes së formaliteteve në përputhje me procedurat e depozitimit doganor dhe kryerjes së kontrolleve doganore nga autoritetet doganore sipas procedurës në fjalë.
- (9) Në disa rrethana, përfitimi i një tarife të favorshme e dhënë me arsyen e llojit apo përdorimit përfundimtar të mallit dhe i tarifave të ndryshme sipas procedurës së përpunimit të jashtëm, duhet të praktikohet në rastet kur një borxh doganor shkaktohet për arsye të ndryshme nga lëshimi i mallrave në qarkullim të lirë.
- (10) Dispozitat në lidhje me vendin ku shkaktohet një borxh doganor, duhet të përfshijnë rregulla të posaçme për raste të veçanta ku shuma në fjalë është më e ulët se një prag i caktuar.
- (11) Është e nevojshme, për çështjen e masave preferenciale, të përcaktohen konceptet e gabimit nga ana e autoriteteve doganore dhe e besueshmërisë së personit përgjegjës për pagesë. Personi përgjegjës për pagesë nuk duhet të mbahet përgjegjës për keqfunksionimin e sistemit sipas një gabimi të bërë nga autoritetet e një vendi të tretë. Lëshimi i një certifikate të pasaktë nga ana e këtyre autoriteteve nuk duhet gjithsesi, të shikohet si gabim nëse certifikata bazohet në një aplikim i cili përmban informacion të pasaktë. Natyra e pasaktë e informacionit të dhënë nga eksportuesi në aplikimin e tij, duhet të vlerësohet në bazë të të gjithë elementeve faktikë, pjesë e atij aplikimi. Personi përgjegjës për pagesë mund të shfajësohet duke vërtetuar se ai ka treguar kujdesin e duhur, përveç se në rastet kur në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane është publikuar një njoftim ku ka baza për dyshim.
- (12) Interesat financiare të Komunitetit dhe të drejtat e personit përgjegjës për pagesë duhet të mbrohen kundër procedimeve ligjore të tejzgjatura.
- (13) Duhet të hartohen dispozita për të pezulluar detyrimin mbi pagesën e një borxhi doganor të shkaktuar kur mallrat janë hequr nga mbikëqyrja e doganave dhe kur ka më shumë se një debitor, në mënyrë që të lejojë autoritetet doganore të fillojnë veprimet e kthimit kundrejt një debitori të caktuar, me përparësi mbi debitorët e tjerë.

(14) Masat e nevojshme për zbatimin e Rregullores (KEE) nr. 2913/92, duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/KE e 28 qershorit 1999, që përcakton procedurat për zbatimin e kompetencave ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë ngarkuar Komisionit<sup>(6)</sup>.

(15) Rregullorja (KEE) nr. 2913/92 ndryshohet si vijon:

## MIRATUAN KËTË RREGULLORE

### Neni 1

1. neni 4 pika 24 , zëvendësohet si vijon:

’24. Procedurë e Komitetit nënkupton , procedurën e referuar në nenet 247 dhe 247 pika a, ose në nenet 248 dhe 248 pika a.’;

2. neni 35 paragrafi i parë zëvendësohet si vijon: ‘Kur faktorët e përdorur për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave janë shprehur në valutë të ndryshme nga ajo e Shtetit Anëtar ku bëhet vlerësimi, kursi i këmbimit që do të përdoret, do të jetë ai i publikuar rregullisht nga autoritetet kompetente të çështjes’;

3. në nenin 77, teksti ekzistues bëhet paragrafi 1 dhe shtohet paragrafi vijues:

‘2. Kur deklarata doganore është bërë me anën e teknikës së përpunimit të të dhënave, autoritetet doganore mund të lejojnë që dokumente shoqëruese siç është referuar në nenin 62, pika 2 të mos depozitohen me deklaratën. Në këtë rast këto dokumente do të vihen në dispozicionin e autoriteteve doganore’;

4. neni 115, pika 4 zëvendësohet si vijon:

Neni 4.” Masat që synojnë ndalimin, detyrimin e disa kushteve ose lehtësimin për mbështetje në paragrafin 1 mund të përdoren në përputhje me procedurën e komitetit “;

5. nenit 117, pika c i shtohet fjalia e mëposhtme: ‘Çështjet në të cilat kushtet ekonomike mendohen të jenë plotësuar mund të përcaktohen në përputhje me procedurën e komitetit.’;

6. neni 124 zëvendësohet si vijon:

### ‘Neni 124

1. Sistemi i rikthimit të pagesës së doganës mund të përdoret për të gjitha mallrat. Megjithatë, nuk do të jetë i zbatueshëm në kohën kur deklarata e kalimit për qarkullimin e lirë pranohet:

-mallrat e importit i nënshtrohen kufizimeve sasiore të importit,  
-një masë tarifore brenda kuotave i aplikohet importit të mallrave,  
-mallrat e importit i nënshtrohen paraqitjes së një licence apo certifikate importi ose eksporti në kuadrin e politikës bujqësore të përbashkët ose,-një kompensim apo taksë eksporti është vendosur për produktet e kompensuara.

2. Për më tepër, asnjë rimbursim i detyrimeve të importit sipas sistemit të rikthimit të pagesës së doganës do të jetë i mundur nëse, në kohën që deklarata e eksportit për produktet e kompensuara pranohet, këto produkte i nënshtrohen paraqitjes së një leje ose certifikate importi ose eksporti në kuadrin e politikës së përbashkët bujqësore ose kur një rimbursim ose taksë eksporti është caktuar për ato.
  3. Ndryshimet në paragrafët 1 dhe 2 mund të vendosen në përputhje me procedurën e komitetit’;
7. Neni 131 zëvendësohet si vijon :

‘Neni 131

“Rastet dhe kushtet e veçanta, sipas të cilave mund të përdoret procedura për përpunim sipas kontrolleve doganore, do të përcaktohen në përputhje me procedurën e komitetit” ;

8. Në nenin 133 pika (e) shtohet fjalia e mëposhtme:

“Rastet në të cilat kushtet ekonomike mendohen të jenë plotësuar mund të përcaktohen në përputhje me procedurën e komitetit’;

9. neni 142 zëvendësohet si vijon:

’Neni 142

1. “Përdorimi i procedurave të përkohshme të importit me heqje të pjesshme të taksave doganore të importit, në përputhje me mallrat të cilat nuk mbulohen nga dispozitat e miratuara në përputhje me nenin 141 ose të cilat mbulohen nga këto dispozita, por që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë nen mbi dhënien e importit të përkohshëm me heqje totale”.
2. “Lista e mallrave, në përputhje të së cilës procedura e importit të përkohshëm me heqjen e pjesshme të taksave doganore të importit mund të mos përdoret dhe kushtet sipas të cilave procedura mund të përdoret do të përcaktohen në përputhje me procedurën e Komitetit”.

10. Neni 153 i shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Duke anashkaluar nenin 151, procedura e komitetit mund të përdoret për përcaktimin e rasteve dhe kushteve të caktuara, sipas së cilës mallrat mund të lihen për qarkullim të lirë duke ndjekur një veprim përpunimi të jashtëm, duke marrë për bazë koston e veprimit të përpunimit me qëllim aplikimin e Tarifave Doganore të Komunitetit Europian”;

11. Neni 167, pika 3 zëvendësohet si vijon:

3. Zonat e lira me përjashtim të atyre të përcaktuara në përputhje me nenin 168 pika (a), do të përfshihen. Shtetet Anëtare do të përcaktojnë pikat e hyrjes dhe daljes të secilës zonë të lirë ose magazinë të lirë’.

12. neni 168, pika 1 zëvendësohet si vijon:

1,” Sipërfaqja, pikat e hyrjes dhe daljes të zonave të lira, përveç zonave të lira të përcaktuara në përputhje me nenin 168, pika (a) dhe magazinave të lira, do t’i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore “.

13 neni i mëposhtëm vendoset midis nenit 168 dhe Kreut B (Vendosja e mallrave në zonat e lira ose magazinat e lira):

neni 168 pika a

1. Autoritetet doganore mund të përcaktojnë zonat e lira ku do të zbatohen kontrollet dhe formalitetet doganore dhe do të aplikojnë klauzolat në lidhje me borxhin doganor në përputhje me kërkesat e procedurës së magazinimit doganor.

nenet 170, 176 dhe 180 nuk do të aplikohen për zonat e përcaktuara si të lira.

2. Referencat për zonat e lira në nenet 37, 38 dhe 205 nuk do të zbatohen për zonat e lira si në paragrafin 1’;

14. Neni 212, pika (a) zëvendësohet si vijon:

‘neni 212 pika (a)

“legjislacioni doganor parashikon zbatimin e një tarife të favorshme të mallrave nisur nga lloji apo përdorimi përfundimtar ose heqjen a përjashtimin e pjesshëm të detyrimeve doganore të eksportit dhe importit në përputhje me nenet 202 deri 205, 210 ose 211, me kusht që sjellja e personit në fjalë nuk përbën mashtrim dhe as pakujdesi dhe ai paraqet dëshmi se kushtet e tjera për zbatimin e trajtimit të favorshëm, heqje ose përjashtim nga taksat janë plotësuar.’;

15. Neni 215 i shtohet paragrafi i mëposhtëm:

‘4. Nëse autoritetet doganore zbulojnë se një borxh doganor është shkaktuar nga neni 202 në një tjetër Shtet Anëtar dhe shuma e këtij borxhi është me vogël se EUR 5 000, borxhi do gjykohet si i shkaktuar në Vendin Anëtar ku është zbuluar.’;

16. neni 220, pika 2, pika (b) zëvendësohet si vijon:

‘(b) sasia e borxhit ligjor të taksës doganore, nuk është përfshirë në llogari për shkak të një gabimi nga ana e autoriteteve doganore i cili logjikisht nuk është diktuar nga personi përgjegjës për pagesën, ky i fundit ka vepruar në besim të plotë dhe në përputhje me të gjitha procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket deklarimeve doganore.

Kur statusi preferencial i mallrave është vendosur në bazë të një sistemi të bashkëveprimit administrativ duke përfshirë autoritetet e një vendi të tretë, lëshimi i një çertifikate nga ato autoritete duhet të vërtetojë pasaktësinë e tij, do të përbëjë një gabim i cili logjikisht nuk do të ishte diktuar në kuptimin e nënparagrafit të parë.

Lëshimi i një çertifikate të pasaktë, megjithatë, nuk do të përbëjë një gabim në qoftë se çertifikata është bazuar në një llogari të gabuar të fakteve të siguruara nga eksportuesi, përveçse kur është e qartë se autoritetet lëshuese ishin në dijeni ose duhej të kishin qenë në dijeni që mallrat nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara mbi klasifikimin për trajtim preferencial.

Personi përgjegjës mund të kërkojë mirëbesim kur mund të tregojë se gjatë periudhës së veprimeve tregtare në fjalë, ka treguar kujdes të veçantë për të siguruar që të gjitha kushtet për trajtim preferencial janë plotësuar.

Personi përgjegjës nuk ka të drejtë të kërkojë mirëbesim nëse Komisioni Europian ka publikuar një njoftim në Fletoren Zyrtare të Komuniteteve Europiane ku deklarohet, se ka dyshime në lidhje me aplikimin e duhur të marrëveshjeve preferenciale nga vendi përfitues;’

17. neni 221, pika 3 zëvendësohet nga paragrafët e mëposhëm:

‘3 Njoftimi drejtuar debitorit, nuk do të jetë më vonë se tre vjet nga data në të cilën është shkaktuar borxhi doganor. Kjo periudhë do të pezullohet në momentin kur depozitohet një apel në kuptimin e nenit 243, përgjithë kohëzgjatjen e procedimeve të apelit.

4. Kur borxhi doganor vjen si rezultat i një veprimi i cili në kohën që është kryer kishte fuqi ligjore të niste një proces penal, shuma mund, sipas kushteve të përcaktuara në klauzolat në fuqi, t’i komunikohet debitorit pas skadimit të periudhës tre vjeçare, referuar në paragrafin 3’;

18. neni 222 pika 2 zëvendësohet si vijon:

‘2. Rastet dhe kushtet, kur detyrimi i debitorit për të paguar taksë doganore do të pezullohet, mund të vendosen në përputhje me procedurën e Komitetit:

-kur bëhet një aplikim për lirim nga taksa doganore në përputhje me nenet 236, 238, ose 239 ose;

-kur mallrat janë sekuestruar me qëllim të një konfiskimi të mëtejshëm në përputhje me nënpikën e dytë të pikës (c) ose me pikën (d) të nenit 233, ose

-Kur borxhi doganor është shkaktuar sipas nenit 203 dhe kur ka më shumë se një debitor.’;

19. nenet 247, 248 dhe 249 zëvendësohen si vijon:

“Neni 247

Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje duke përfshirë zbatimin e Rregullores së referuar në nenin 184, përveç Titullit VIII dhe, sipas neneve 9 dhe 10 të Rregullores (KEE) nr. 2658/87(7) dhe nenit 248 të kësaj Rregulloreje do të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore të referuar në nenin 247a, pika 2 në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të miratuara nga Komuniteti.

Neni 247 pika (a)

1. Komisioni do të ndihmohet nga Komiteti i Kodit Doganor (i quajtur më poshtë “Komiteti”).
2. Në rastet kur do t’i referohemi këtij paragrafi, nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE do të zbatohen, ne përputhje me klauzolat e Neni 8 te tij.

Periudha e parashikuar në nenin 5, pika 6 të Vendimit 1999/468/KE do të jetë tre muaj.

3. Komiteti do të miratojë rregullat e procedurës.

Neni 248

Masat e nevojshme për zbatimin e neneve 11,12 dhe 21 , do të miratohen në përputhje me procedurën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 248 pika (a) nënpika (2).

Neni 248 pika (a)

1. Komisioni do të ndihmohet nga Komiteti i Kodit Doganor, i quajtur më poshtë “Komiteti”.
2. Në rastet kur do t’i referohemi këtij paragrafi, nenet 4 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE do të zbatohen.

3. Komiteti do të miratojë rregullat e procedurës.

Neni 249

Komiteti mund të hartojë çdo çështje në lidhje me legjislacionin doganor që ngrihet nga kryetari i tij ose me iniciativën e tij, ose me kërkesën e përfaqësuesve të Shteteve Anëtare”

---

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Kjo Rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 16 nëntor 2000

Për Parlamentin Evropian  
Presidenti  
F.Fontaine

Për Këshillin  
Presidenti  
R.Schwartzenberg

---

<sup>(1)</sup> Gazeta Zyrtare C 228, 21.7.1998, fq 8 dhe Gazeta Zyrtare C 248E, 29.8.2000 fq.1.

<sup>(2)</sup> Gazeta Zyrtare C 101, 12.4.1999, fq.6.

<sup>(3)</sup> Mendimi i Parlamentit Evropian i 12 marsit 1999 (Gazeta Zyrtare C 175, i 21qershorit 1999, fq. 420), Pozita e Përbashkët e Këshillit e 25 majit 2000 (Gazeta Zyrtare C 208, 20.7.200, fq.1) dhe Vendimi i Parlamentit Evropian i 5 tetorit 2000.

<sup>(4)</sup> Gazeta Zyrtare L 302, 19.10.1992, fq.1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 955/99 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (Gazeta Zyrtare L 119, 7.5.1999, fq.1)

<sup>(5)</sup> Gazeta Zyrtare C 332, 17.11.1996, fq.1

<sup>(6)</sup> Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, fq.23

<sup>(7)</sup> Gazeta Zyrtare L 256, 7.9.1987, fq.1